

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 23.11.2021 në orën 11.00, në selinë e Shoqërisë "Green Coast" sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L41329038D, me adresë në Njesia Bashkiake nr.2, rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti 31, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("Ortaku i Vetëm").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 2,413,522,828 LEK (dy miliard e katërqind e e trembëdhjetë milionë e pesëqind e e njëzet e dy mijë e tetëqind e njëzet e tetë lekë). Ne kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka përformuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 242,540,000 LEK (dyqind e dyzet e dy milionë e pesëqind e dyzet mijë lekë).


Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zvoglimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 242,540,000 LEK (dyqind e dyzet e dy milionë e pesëqind e dyzet mijë lekë).
- B. Kapitali i Shoqërisë nga 2,413,522,828 LEK (dy miliard e katërqind e e trembëdhjetë milionë e pesëqind e e njëzet e dy mijë e tetëqind e njëzet e tetë lekë) bëhet **2,170,982,828 LEK (dy miliard e njëqind e shtatëdhjetë milionë e nëntë qind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e tetë lekë).**
- C. Të autorizojë Administratorin e shoqërisë për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KRYETARI


Znj. Edlira Muka

SEKRETARI


Znj. Rozana Kodrari

